



GLOBAL
ENVIRONMENT
FACILITY



Albania



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Prespa ime

gazetë informuese e procesit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për komunat e Parkut të Prespës,
botohet në kuadër të projekti për Menaxhimin e Integruar të Ekosistemit të Basenit të Prespës



Komunat Liqenas dhe Progër punojnë në hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis

Specialistë të komunës Liqenas dhe Progër, si dhe specialistë në nivel rajonal e kombëtar, po vijnë punën e nisur që në muajin korrik të këtij viti për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për komunat Liqenas dhe Progër.

Gjatë këtyre muajve janë organizuar një sërë takimesh ndërmjet specialistëve dhe janë identifikuar problemet në komunat Liqenas dhe Progër. Këto problematika paraqiten shkurtimisht në këtë gazetë, ndërkohë që përmbledhja e përgjithshme mund të gjendet pranë komunës.

Grupi po punon në vlerësimin e gjendjes në disa drejtime, në: vlerësimin e pasurive natyrore dhe menaxhimin e tyre; bujqësia dhe menaxhimi i saj; zhvillimi rural; zhvillimi i turizmit, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit, etj. Këto fusha po analizohen dhe është nxjerrë lista e problemeve, si dhe shkaqeve që kanë çuar në këtë gjendje.

Në fund të procesit, grupi do të përpikët t'i japë zgjidhje këtyre problemeve duke përcaktuar masat dhe ndërhyrjet konkrete në përmirësimin e gjendjes.

Pjesëmarrja e publikut është shumë e rëndësishme për këtë proces. Me anë të kësaj gazete, posterave që janë vendosur nëpër fshatrat e komunës, fletoreve edukative për nxënësit e shkollave, veprimtarive edukuese dhe ndërgjegjëse, ndihmave pilote për përmirësimin e gjendjes, si dhe takimeve direkte me banorët, synohet të merret mendimi i sa më shumë banorëve në këtë proces. Dokumenti që poërgatitet është shumë i rëndësishëm për gjenerimin e financimeve dhe tërheqjen e donatorëve në zonën e liqeneve të Prespës.

Së bashku me komunat Liqenas dhe Progër është përfshirë dhe komuna Qendër Bilisht në hapat e hartimit të këtij procesi për të hartuar një plan të përbashkët përmirësimi të trajtimit të Parkut të Prespës.

Grupi i punës ka hartuar një dokument paraprak, ku përfshihen një vizion për komunitetin, analiza e gjendjes, lista e problemeve dhe Plani i Veprimit. Ky dokument paraprak është i hapur për diskutim me banorët për të shkruar një dokument ku të gjithë të japim ndihmesën dhe kontributin tonë.



Qëllimi i kësaj gazete

Kjo gazetë është organ i projektit të Menaxhimit të Integruar të Ekosistemit të Basenit të Prespës.

Qëllimi i kësaj gazete është të informojë banorët e Parkut të Prespës mbi vlerat e këtij Parku si dhe synimet e projektit dhe komponentëve të saj.

Në këtë gazetë do të trajtohen të gjithë objektivat e projektit dhe, në veçanti, komponenti i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për komunat Progër dhe Liqenas.

Gjithashtu, kjo gazetë ka si qëllim të tërheqë vëmendjen tuaj mbi zhvillimin e qëndrueshëm të këtij Parku dhe t'ju ftojë të jeni pjesë aktive e zhvillimeve që po ndërmerret për këtë qëllim.

Gazeta do t'ju bëjë të ditur rezultate të punës nga projekti si dhe do të trajtojë tematika problemore dhe do të përpikët të shërbejë si pasqyrë e mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Pjesëmarrja publike në këtë projekt është jetësore në zhvillimin e qëndrueshëm të Parkut të Prespës dhe në arritjen e rezultateve që përfshijnë mendimin dhe dëshirën për zhvillim të banorëve të Parkut.

Stafi i projektit ju fton të jeni pjesë aktive e këtij zhvillimi duke dhënë kontributin tuaj në aktivitetet publike dhe paraqitur mendimet tuaja pranë personave të kontaktit.

Çfarë ka të drejtë publiku?

Sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, publiku ka të drejtë:

- * të marrë jo vetëm informacion, por edhe dokumentacionin e duhur dhe vendin se ku mund të gjendet ai;
- * ta marrë informacionin sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
- * të marrë informacion pa treguar përse nevojitet ai;
- * të marrë përgjigje se përse nuk është përmbushur një kërkesë e caktuar.
- * përfshirjen drejtpërsëdrejti në marrjen e vendimit;
- * përfaqësimit të interesave të qytetarëve (duke ushtruar presion mbi autoritetet, lobimit, ndërtimit të projekteve të partneritetit me specialistë të ndryshëm, etj);
- * gjetjes së rrugëve të dobishme dhe krijuese për monitorizuar dhe ndikuar procesin e vendimmarrjes.

Përfitimet nga pjesëmarrja

- * Nivel më i lartë i zbatimit të parimeve të demokracisë;
- * Kontrollohen më mirë veprimet e autoriteteve publike;
- * Përmirësohet cilësia e vendimeve të marra duke u afuar me nevojat e publikut;
- * Zbatimi i vendimeve është më i mirë kur vendimi është marrë në bashkëpunim.



Parku i Prespës vlerë e natyrës

Zona e Prespës është një nga zonat më të bukura natyrore të Shqipërisë, e cila kërkon kujdesin e secilit prej nesh.

Në pjesën shqiptare të Parkut të Prespës, vlerësohet se popullsia është në rritje ose e qëndrueshme dhe me një dendësi relativisht të lartë të popullsisë me 20 banorë për metër kator. Brenda kësaj popullsie, 23%

janë të papunë dhe të ardhurat mesatare vjetore janë rreth \$700, në të cilën angazhimi në bujqësi përbën rreth 70% të krahut të punës. Në pjesën shqiptare të parkut nuk ka ndonjë zhvillim industrial.

- Frutat e egra dhe bimët mjekësore janë të rëndësishme për gjenerimn e të ardhurave për banorët e parkut.
- Speciet unike: flora e pjesës shqiptare të Parkut Kombëtar të Prespës numëron rreth 1000 specie, ose 30% të gjithë florës së Shqipërisë.
- Numërohen rreth 50 specie të faunës dhe rreth 19 specie bimore të cilat gjenden vetëm në pellgun ujëmbledhës të Prespës, 1600 specie fluturash dhe një diversitet i madh amfibësh dhe reptilësh.
- Parku i Prespës është një vend globalisht i rëndësishëm për ushqimin, shumëzimin dhe folenizimin e rreth 91 specieve të zogjve migratorë, përfshi edhe specien vulnerabël të Pelikanit Kaçurrel.
- Të paktën 19 specie të faunes në Park janë të rrezikuara
- Niveli i zhvillimit të turizmit është relativisht i ulët, po lidhjet midis mbrojtjes së mjedisit dhe turizmit po bëhen më të qarta dhe më të rëndësishme, sepse ekoturizmi po zhvillohet në këtë zonë edhe në gjithë vendin.

Statusi Park Kombëtar

Parku Kombëtar i Prespës, që ka një sipërfaqe prej rreth 23000 ha, u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 80, datë 18.02.1999 si Park Kombëtar dhe në Shkurt të vitit 2000 u nënshkrua Deklarata e Përbashkët e tre kryeministrave të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë, ku u shpall Park Ndërkombëtar.

Sipërfaqja e Parkut përfshin tokë bujqësore, tokë pyjore, kullota, livadhe, gjithë sipërfaqen ujore dhe sipërfaqet joproduktive. Klasifikimi sipas rëndësisë së ruajtjes është bërë si më poshtë:

Zona e mbrojtur I (zona rreptësisht e mbrojtur) që përfshin Livadhin e Xhores (lartësia 1.024 m) deri tek lartësia 1.163 m (Pika e Drushit), 1.718 m pylli i quajtur Manastir, në fshatin Kallamas (sipërfaqja 900 ha) dhe pjesa e Osojes.

Zona e mbrojtur II (zona e menaxhuar) që përfshihet midis vijave niveluese, në lartësi 1900 m dhe kufirin e tokës së bukës në fshatin Goricë e Madhe, rruga Zaver – Bigell, deri në lartësinë 1529 m, zona midis gjirit të Zaroshkës, faqja veriore e malit Ivan, pjesa e përparme, lartësia 1768 m dhe 1456 m, e në perëndim kufiri me zonën bujqësore të Cerjes dhe pyjet e Kallamasit.

Zona e mbrojtur III (zona e zhvilluar) ku përfshihet toka bujqësore, zonat e banuara, infrastruktura si p.sh. sistemi i rrugëve. Të gjitha zonat periferike të pyjeve, që nuk janë pjesë e zonave të mësipërme.

Zona për zhvillimin me përparësi të turizmit, vija bregliqenore nga Kallamasi në Liqenas.

Kuadri ligjor

Ligji për zhvillimin si zonë me përparësi turistike, Ligji 9358/2005 për pyjet dhe shërbimin pyjor, Ligji 9048/2003 për trashëgiminë kulturore, Ligji 8906/2002 për zonat e mbrojtura, VKM nr. 266 datë 24.04.2003 për krijimin e administratës së parkut, VKM nr. 86 datë 11. 02. 2005 për krijimin e ekonomisë të menaxhuar, etj.

Turizmi në Liqenas

Llojet e turizmit në rajon

Në komunën Liqenas kemi turizem liqenor, turizëm malor, turizëm kulturor.

Plazhe ku mund të investohet janë:

- Në fshatin Zaroshkë (plazh ranor dhe shkëmbor)
- Në fshatin Liqenas (shkëmbor)
- Në fshatin Gollomboç (plazh ranor dhe shkëmbor)
- Në fshatin Goricë e Vogël (ranor)
- Në fshatin Kallamas (ranor dhe shkëmbor)

Zaroshka është plazhi më i preferuar nga vizitorët.

Edhe në dimër Prespa tërheq mjaft vizitorë, të cilëve u ofrohen mjaft mundësi për ski.

Informimi i publikut

Ndihet mungesa e organizimit të informacionit turistik.

Rolin e qendrës për informim të publikut në komunën Liqenas e luajnë :

1. Stacioni i Parkut në Goricë të Vogël;

2. Shkolla e mesme e përgjithshme në Liqenas;
3. Shkolla 9-vjeçare në Goricë të Vogël.

Numri i vizitorëve në 3 vitet e fundit

1. Me fjetje 25%, 10% me prentim
2. Ditor 75% , 16.000 mijë vizitorë brenda një viti

Rrjeti i objekteve në shërbim të turizmit

Në komunën Liqenas ekzistojnë 13 bar bufe, 4 hotele +motele

Në këtë biznes janë të punësuar 28 njerëz.

Shumë shtëpi në Zaroshkë, Liqenas, Gollomboç, Goricë e Vogël dhe Kallamas janë përgatitur të presin turistë e t'u sigurojnë komoditetin e duhur, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit familjar.



Projekti “Menaxhimi i integruar i ekosistemit të basenit të Prespës”

“Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Basenit të Liqeneve të Prespës në Shqipëri, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Greqi (Shtator 2006 -Shtator 2011).

Objektivi i këtij projekti është të nxisë adaptimin e menaxhimit të integruar të ekosistemit në zonën ndërkufitare të basenit të Liqenit të Prespës në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Shqipëri dhe Greqi për të ruajtur biodiversitetin e rëndësishëm në shkallë globale, për të zbutur ndotjen në liqenet ndërkufitare, dhe për të siguruar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror të Bazenit

Projekti i Parkut të Prespës do të mbrojë banorët lokale dhe vendbanimet e tyre (të tashme dhe të ardhme) në procesin e mbrojtjes së mjedisit përreth tyre, duke minimizuar shkaqet njerëzore të cilat sjellin shkatërrimin, degradimin ose dëmtimin e ekosistemit natyror të Prespës.

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) është dokument i politikës mjedisore vendore, që pasqyron përparësitë dhe detyrat në fushën e mjedisit, veprimtaritë dhe masat që do të ndërmerren për zgjidhjen e tyre, identifikon organet dhe strukturat që do të angazhohen, secila në linjën e vet, si dhe përlogarit kostot dhe mbështetjen financiare të nevojshme. PLVM hartohet në nivel qarku, rrethi, bashkie e komune. Përgatitja e tij duhet mbështetur në metodën gjithëpërfshirëse ku çdo individ i komunitetit ka të drejtën e dhënies së kontributit të tij në këtë proces

Përmes përgatitjes së PLVMsë zhvillohen aftësitë e pushtetit vendor, subjekteve të ndryshme të interesuara për mjedisin dhe gjithë komunitetit; nxitet bashkëpunimi midis pushtetit vendor dhe atij qendror, organizatave jofitimprurëse, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendim-marrjes.

Procesi i përgatitjes së një PLVMje mund të kryhet në disa mënyra. Pikat e mëposhtme paraqesin një prej tyre:

Njohja e procesit dhe hartimi i strategjisë së punës për përgatitjen e PLVMsë.

Ngritja e grupit (grupeve) të punës

Hartimi i strategjisë për përfshirjen e publikut

Përshkrimin e situatës ekzistuese në zonë.

Përcaktimi afatgjatë i qëllimeve të komunitetit (krijimi i vizionit dhe realizimi i qëllimeve strategjike të së ardhmes)

Përcaktimi dhe vlerësimi i problemeve mjedisore lokale.

Përshkrimi i hollësishëm i nevojave reale (përcaktimi i qëllimeve specifike dhe veprimeve konkrete prioritare).

Përshkrimi i hollësishëm i veprimeve të planifikuara.

Monitorimi i veprimtarive të planifikuara

PLVMtë janë të lidhura ngushtë edhe me zhvillimin e aktiviteteve të tjera, si programet kombëtare e rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm, Axhendën Lokale 21 dhe sistemet për menaxhimin e mjedisit. Shumë prej këtyre programeve kanë metodologji të ngjashme, pasi përdorin qasjen sipas planifikimit strategjik dhe mbështeten në përfshirjen e gjerë të grupeve të interesuara.

REC Shqipëri

Qendra Rajonale e Mjedisit për Europën Qendrore e Lindore (REC) është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse me mision mbështetjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Europën Qendrore e Lindore (EQL). Qendra e përmbush misionin e saj duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore.

REC është krijuar në 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Komisioni European dhe Hungaria. Sot REC bazohet ligjërisht në Kartën e REC, nënshkruar nga 29 vende dhe Komisioni European dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 17 vendeve përfutuese, të cilat janë: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, RIJ e Maqedonisë, Polonia, Rumania, Serbia, Mali i Zi, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia.

Donatorët më të fundit janë Komisioni European dhe qeveritë e Shqipërisë, Austrisë, Belgjikës, Bosnje-Hercegovinës, Kanadasë, Kroacisë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Gjermanisë, Hungarisë, Italisë, Japonisë, Letonisë, Lituanisë, RIJ të Maqedonisë, Hollandës, Norvegjisë, Polonisë, Serbi-Malit të Zi, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, si dhe organizata të tjera ndërqeveritare dhe institucione private.



Uji

Ujërat sipërfaqësore

Liçeni i Prespës së Madhe

Liçeni i Prespës së Madhe ka një sipërfaqe prej 45,5 kilometra katrore dhe një thellësi maksimale 55 m. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 850 m. Këtu duhet vënë në dukje se, për shkaqe dhe arsye të panjohura, që prej vitit 1988 niveli i ujit në liqen është ulur në mënyrë drastike, afërsisht 8 m. Aktualisht lartësia mbi nivelin e detit është 842 m. Sipas disa studimeve, niveli mesatar në liqen ndjek një variacion sezonal. Brenda vitit mund të shihen modele të tjera të evolimit, të cilët ndryshojnë në varësi të ekzaminimit.

Pra është për t'u përmendur se një tendencë rritjeje është vëne re në periudhën 1954 – 1962, ne vitin 1963 ka pësuar një rënie te ndjeshme prej 2,5 m, kjo rënie u duk qartë deri në vitin 1978 dhe pastaj një ngritje që është vënë re ndërmjet viteve 1979 – 1988. Nga viti 1988 e në vazhdim, kemi një rënie të nivelit të liqenit. Rënia e vazhdueshme e nivelit të liqenit që prej vitit 1988 është shqetësuese, por me sa dihet, që në fillim të shekullit XIX, liqeni ishte 10 m më i ulët se sa sot, këtë e tregojnë disa objekte dhe vendbanime të vjetra që gjenden në lartësinë 840 m mbi nivelin e detit. Niveli i ujit luhatet çdo vit 0,5 – 1,75 m, ndërsa në çdo 20 – 25 vjet arrin 4,50 m; oshilacione të mëdha periodike shfaqen për çdo 20 – 25 vjet.

Rënia e nivelit të ujit në liqen nuk është hetuar akoma, sidoqoftë supozohet se periudha e thatë mbas vitit 1988, në kombinim me rrjedhje të pakontrolluara në Liqenin e Ohrit dhe rritja e përdorimit të ujit nga njerëzit nga të tre vendet, rezultojnë në praninë e një fenomeni të tillë.



Bujqësia

Komuna Liqenas

Në ekonominë e Liqenasit, puna direkt në bujqësi është shumë e pakët. Sot nuk kemi asnjë familje që të merret me bujqësinë. Kjo vjen për disa arsye: i) Mosgrumbullimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe mospërpunimi i tyre; ii) Infrastruktura jo e mirë që lidh fshatrat e komunës me qytetin e Korçës; iii) Rendimente të ulëta, si rezultat i mosujtjes së tokës; Copëtimi i tokës, i cili sjell mosinteresimin e fshatarëve për kultivimin e kulturave bujqësore; iv) Mosçertifikimi i prodhimeve biologjikisht të pastra dhe të prodhuara në Parkun e Prespës, me qëllim që çmimet të jenë më të larta nga komunat e tjera; v) Me përmirësimin e këtyre kushteve, prodhimet do të rriten dhe vetë fshatarët do të kenë interes që të merren me bujqësinë.

Sistemi drenazhues dhe kullues

Sistemi i kullimit në fushë, në këtë komunë, ka qenë shumë i mirë. Të gjithë tokat që shtrihen në fushë janë të sistemuara, të niveluara dhe të parcelizuara, ku janë ndërtuar kanale të dyta dhe të treta kulluese. Tokat e drenazuara kapin një sipërfaqe prej 20 ha. Sistemimi i kullimit si dhe pastrimi i kanaleve të dyta dhe të treta para vitit 1991 kryhej sistematikisht. Këto vitet e fundit, me ndarjen e tokave, kanalet e dyta dhe të treta po mbushen, se nuk ka interes për pastrimin e tyre. Sot funksionon vetëm 50 % e sistemit kullues.

Të njëjtin fat kanë dhe drenazhimet që janë të bllokuara si rezultat i mospastrimit të kanaleve.

Komuna Progër

Toka bujqësore, momentalisht, përdoret për kultivimin e bimëve prashitëse (30%) e sipërfaqes të përgjithshme; drithra (25%) dhe pemëtaria (45%) të sipërfaqes të tokës bujqësore. Tendenca është për shtimin e sipërfaqeve me pemë frutore .

Blegtoria nuk është më prioritet i banorëve të zonës. Aktualisht, numri i familjeve që merren me blegtori është rreth 15 dhe numri i krerëve të bagëtive të trasha është 850 dhe i të imëtave 2430 krerë. Tendenca është për heqjen dorë nga blegtoria si aktivitet, duke u reduktuar ndjeshëm numri i personave që do të merren me këtë fushë.

Mesatarisht rendimenti i drithrave është 35 kv/ha dhe ai i pemëtarisë 400 kv/ha. Kjo prodhimtari mund të rritet, pasi tendenca e fermerëve të zonës është për rritjen e numrit të mjeteve të mekanikës bujqësore dhe përdorimit të plehrave kimike .

Pjesa dërmuese e popullsisë, 95 %, i është kushtuar bujqësisë .

Përfitimet ekonomike për familje në vit, nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale, arrin mesatarisht në 4000-5000 dollarë dhe këto të ardhura kanë tendencën për t'u rritur pasi fermerët po përqendrohen në kultivimin e një kulture bujqësore, ku dhe eficaenca në prodhim mund të jetë më e madhe.

Aktualisht, kimikatetet në bujqësi përdoren në një masë të konsiderueshme dhe tendenca është në shtimin e përdorimit të tyre jo vetëm në bujqësi, por dhe në pemëtarë. Kjo natyrisht nuk do të ndikonte pozitivisht në mjedis, në bletari dhe në prodhimin e bio-produkteve .



Pyjet

Komuna Liqenas

Pyjet, në komunën Liqenas përfaqësojnë ekosistemin natyror më potent, me sipërfaqe më të madhe dhe biodiversitetin më të lartë. Sipërfaqja e përgjithshme e tyre është 11473 ha, nga të cilët, në pikëpamje administrative, 7316 ha janë shtetërore , 3723 ha janë në përdorim të komunës dhe 434 ha janë pyje private; kurse nga pikëpamja e qeverisjes teknike, 824 ha janë trungishte ahu, 9134 ha janë cungishte dushku e ahu, dhe 1515 ha janë shkurre.

Një bimësi e pasur drunore, shkurre e barishtore shtrihet në tre zonat fitoklimatike të *Castanetum*-it, *Fagetum*-it dhe *Alpinetum*-it brenda territorit të komunës Liqenas e njëherësh Parkut Kombëtar.

Pyjet, para vitit 1990, në këtë zonë, shfrytëzoheshin mbi normën vjetore të rritjes. Nga këto çdo vit merreshin 20000 m³ dru zjarri dhe lëndë. Si rezultat i ndryshimit të sistemit, pas vitit 1992, filluan shkatërrime masive. Cungishtet e dushkut janë çuar deri në degradim prej keqpërdorimit të tyre në tre aspekte: së pari, prej prerjeve abuzive për prodhim drush zjarri; së dyti, prej kullotjes së dhive në to; së treti, prej prerjes së gjethit për rezervë ushqimore për dhitë. Me daljen e ligjit për dhënien në

përdorim pyjet komunitetit, gjatë viteve 2000-2001, u përgatit plani i menaxhimit të pyjeve komunale, i cili vlerësoi gjendjen aktuale të këtyre pyjeve dhe përcaktoi masat që duhet të merreshin për çdo parcelë dhe me afate kohore. Me anë të donacioneve të ndryshme nga GTZ, BB, MADA dhe KFW u bënë përmirësime në 350 ha, ricungime në 200 ha dhe pyllëzime 15 ha. Këto u bënë nga shoqata e përdoruesve të pyjeve komunale dhe nga firma të ndryshme.

Komuna Progër

Në komunën Progër sipërfaqja më e madhe pyjore ndodhet në pjesën perëndimore të malit të Moravës, si dhe në pjesën lindore në malin e Ivanit , sipërfaqet që zënë pyjet është 750 ha ose 25 % të sipërfaqes totale të territorit të komunës. Prerja pa kriter dhe zjarret e shpeshta në vitet e fundit ka bërë që shpyllëzimi të mbetet një nga problemet kryesore që shqetëson komunitetin .

Me zhvillimin ekonomik-shoqëror të zonës, pejsazhi, nga ana mjedisore është në ndryshim të vazhdueshëm. Pozitiv është shtimi i numrit të drurëve frutorë, ndërtimet e reja, përmirësimi i vazhdueshëm i asfaltimit të rrugëve, ndërtimi i sistemeve të reja të ujësjellës-kanalizimeve etj, ndërsa efektet negative në pejsazhin e komunës japin shpyllëzimi dhe prerjet abuzive dhe pa kriter, kënetëzimi i Liqenit të Prespës dhe mosgrumbullimi apo përpunimi i mbetjeve urbane .

Vlerësimi i burimeve

(Komuna Liqenas)

Ujërat

- Liçeni i Prespës së Madhe ka një regjim hidrologjik të qëndrueshëm, me oshilacione në periudha të mëdha kohe. Kjo sepse ai ushqehet nga burimet karstike në fundin e tij, pra nga ujërat nëntokësore. Ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore, prurjet e të cilave varen nga reshjet, janë një ushqim sekondar, me peshë më të vogël. Prandaj dhe prurjet e tyre të ngurta mund të konsiderohen të pakta.

- Liçeni i Prespës së Vogël është dëmtuar në atë shkallë sa ka ndryshuar përfundimisht gjendjen e vet duke u kthyer në kallamishte.

- Ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore janë me rrjedhje sezonale, me shfaqje të kufizuar të erozionit në thellësi e në brigje.

Ajri

Përgjithësisht, ajri është i pastër, me ndotje të pakët. Me e ndjeshme është ndotja nga avullimi i plehrave organike dhe ujërave të zeza të zbuluara.

Toka

- Toka bujqësore përdoret pjesërisht. Ka nivel të ulët të punimit me mjete të mekanizuara, ka prezencë të konsiderueshme të gurëve në të, ndotje relativisht të paket nga kimikatet, sistem kullues difektoz.

- Toka pyjore ka përmbajtje të ulët të humusit, thellësi të pakët, me prezencë të konsiderueshme të shkëmbit amnor në sipërfaqe, me erozion sipërfaqësor të zhvilluar mesatarisht në sipërfaqet e dushkajave të dëmtuara, procesi tokëformues në vazhdim.

Biosfera

- Pyjet paraqesin tablo të ndryshme: ka pyje në gjendje të mirë e në rritje, ka pyje të përmirësuar dushku që po rehabilitohen plotësisht, ka pyje dushku të dëmtuar, që meritojnë mbrojtje strikte, ka pyje me statusin e zonës së mbrojtur për vlera të caktuara biodiversiteti që përsëri meritojnë mbrojtje strikte.

- Kullotat natyrore alpine të Malit të Thatë janë të pashfrytëzuara aktualisht dhe kanë kapacitete ushqyese të konsiderueshme; ka kullota të tjera që janë në mes të parcelave pyjore që duhen kullotur në mënyrë racionale.

-Bimësia e rrallë dhe ajo e rrezikuar, sikurse dhe kafshët e pyllit e ihtiofauna e liqenit duhen mbrojtur me fanatizëm dhe vetëm në një të ardhme mund të realizohen gjuetia e peshkimi si disiplina që rregullojnë popullimet.

Pejsazhi malor

Malet, shkëmbinjtë e bukur e të larmishëm na prezantojnë një pejsazh të madhërishtë që duhet ta ruajmë të paprekur.

Mjedisi social dhe ekonomik

Situata është komplekse, ka sektorë ekonomikë si bujqësia (tendenca drejt bujqësisë natyrore), turizmi, peshkimi etj. që mund të zhvillohen harmonishëm me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, në pajtim të plotë me mjedisin.

Ka sektorë apo nënsektorë që duhet të ndryshojnë ecurinë aktuale, pasi janë në kundërshtim apo mospajtim me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin, si blegtoria (kryesisht dhitë me kullotjen e pakontrolluar të pyllit), sistemimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave, përfitimti dhe përdorimi i energjisë.

Ka sektorë që thjesht kërkojnë ritme të larta zhvillimi si infrastruktura rrugore, furnizimi me ujë të pijshëm, tregëtia, zhvillimi i fshatrave sipas planeve rregullues.



Peshkimi

Komuna Liqenas

Llojet e peshkimit në zonë

Peshkimi është një sektor me përparësi, sidomos për fshatrat që janë në afërsi me bregun e liqenit. Para vitit 1990, në Komunën e Liqenasit ishin dy brigada peshkimi me 5 (pesë) motobarka, që bënëin gjuetinë e peshkut. Pas vitit 1990, ky sistem punë u prish dhe gjuetia e peshkut filloi të bëhet individuale, e paorganizuar dhe gjatë gjithë periudhës së vitit. Pas vitit 2002, u krijua një shoqatë peshkimi dhe u licensuan 30 peshkatarë. Nga llojet e peshkimit, më të përhapur janë: peshkimi me rrjeta, me pezaul, potisok dhe me grep.

Në gjuetinë me rrjeta ka disa rrjeta që janë me dimensione të vogla që kapet peshku i vogël dhe nuk është i konsumueshëm.

Me pezaule bëhet peshkimi në kohën e shtimit të peshkut: cirones, klenit, mrenës dhe sklobusit. Peshkimi me potisok përdoret për gjuetinë e krapit në periudhën e shtimit. Peshkimi me grep përdoret edhe si peshkim sportiv dhe turistik.

Akuakultura në zonë

Para vitit 1990, në komunën e Liqenasit kishte dy pika të tilla. Një qendër kultivimi në liqen në vendin e quajtur Zaver, në fshatin Goricë e Vogël dhe një qendër kultivimi në fshatin Zvezdë, ku kultivohej peshku dhe hidhej në liqen. Por pas vitit 1990 deri në 2005, ky kultivim nuk u zhvillua. Gjatë kësaj kohe nuk u hodh asnjë lloj peshku. Nga viti 2005, filloi të kultivohet rasat peshku në Zvezdë dhe, në vitin 2007, u bë e mundur hedhja e këtij rasati në liqen. Projekte të tjera në këtë fushë nuk janë zbatuar.

Komuna Progër

Peshkimi është ushtruar dhe ushtrohet në zonat e Prespës së Vogël, por me problemet e kënetëzimit që ka ky liqen, ai nuk është prioritet i banorëve të kësaj zone. Gjendja e peshkimit është në përkeqësim të vazhdueshëm.

Aktualisht, nuk ka ndonjë nismë të akuakulturës në zonë.



Mjedisi social

Komuna Liqenas

Ujërat e zeza

Fshatrat e zonës së Prespës, për vetë pozicionet e tyre të shtrirjes sipas relievit natyror, kanë nevojë për sisteme të veçanta të ujërave të zeza. Kjo del më se e nevojshme edhe për vetë faktin se, me zhvillimin e turizmit familjar, shtohet sasia e ujit që përdoret nëpër familje dhe objekte të veçanta turistike, që kërkon edhe rrjetin për shkarkimin e tyre. Megjithatë, vetëm në dy fshatra të zonës, vetëm në fshatrat e Liqenasit dhe të Zaroshkës janë ndërtuar sisteme të ujërave të zeza të rregullta dhe sipas standardeve të kohës. Ato janë të pajisura edhe me kolektorë për grumbullim e pastrim, me qëllim që ujërat që derdhen në Liqen të mos sjellin ndotjen e tij.

Me qëllim që në zonë të ruhet pastërtia ekologjike e saj, që të mos krijohen premisa nëpër fshatra për përhapjen e epidemive nga derdhjet e ujërave të zeza nëpër kanalet dhe rrugët e fshatit, me qëllim që fshatrat e zonës të kenë të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar turizmin familjar, duhet të merren masa, të hartohen projektet për çdo fshat për sistemet e ujërave të zeza nga ana e komunës, si edhe të gjenden fondet e nevojshme nga ana e shtetit dhe nga donatorë të tjerë me qëllim që të ndërtohen sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha sistemet e ujërave të zeza sipas fshatrave. Sistemet e ujërave të zeza duhet të pajisen edhe me kolektorë e sisteme pastrimi (dekantues), për të ulur maksimlaisht nivelin e ndotjes nga ujërat që derdhen në liqen.

Mbetjet

Mbetjet urbane në zonën e Prespës, kryesisht janë nga burimet shtëpiake, si edhe nga ana e disa objekteve të biznesit të vogël privat. Megjithatë, ato, për shkak të mungesës së pikave të ndërtuara për grumbullimin dhe përpunimin e tyre (që ekzistojnë vetëm në dy fshatra të zonës), si dhe për shkak të mospasjes së fondeve të nevojshme për grumbullimin dhe transportimin e tyre në vende të caktuara, përbëjnë faktorin kryesor të ndotjes së mjedisit pothuaj në të gjitha fshatrat e zonës.

Komuna Progër

Disponohen plane rregulluese të të gjithë fshatrave të viteve 1980-1984. Planet rregulluese të viteve të fundit që t'i përshtaten zhvillimit të zonës nuk ka dhe për ndërtime të reja punohet me plane rregulluese pjesore .

Furnizimi me ujë në fshatrat Pilur, Bickë, Vranisht, Cangonj është me rrjedhje të lirë, kurse në fshatrat Progër, Maçurisht, Rakickë dhe Shuec, furnizimi është me ngritje mekanike. Prurjet e ujit janë të mjaftueshme, por problem mbetet rrjeti shpërndarës i fshatrave që është shumë i amortizuar nga koha e gjatë e përdorimit, si dhe nga ndërhyrjet e paligjshme në rrjet. Zgjidhja e problemit mbetet zbatimi i projekteve shpërndarëse.

Kanalizimi i ujërave të zeza është i rregullt dhe i ndërtuar në vitet e fundit, ndërsa në fshatrat e tjerë nuk ekziston, ndërtimi i sistemeve të kanaleve të ujërave të zeza është një problem akut dhe që kërkon një zgjidhje të menjëhershme, pasi ka ndikimin e vet negativ në mjedis, në cilësinë e ajrit, për vetë pasojat shëndetësore që mund të krijohen. Gjendja në fshatrat ku nuk është ndërhyrë është në përkeqësim të vazhdueshëm .

Kolektorët dhe sisteme të tjerë për largimin e ujërave të zeza nuk ka, largimi nga qendrat e banuara bëhet në mënyrë private nga vetë njerëzit .

Ju lutem përgjigjuni pyetjeve në këtë formë duke shënuar në kutitë e bardha.

Griseni pjesën e pyetësorit dhe dhe dorëzoheni atë tek shpërndarësi i kësaj gazete apo pranë komunës Liqenas.

Kontributi juaj është mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në ndërmarrjen e nismave në të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës tuaj.

Cilat mendoni se janë vlerat më të mëdha të Parkut të Prespës dhe komunës tuaj në veçanti? Përmendni shkurt disa.

Cilët janë mendoni se janë problemet më të rëndësishme në rajonin e Prespës dhe veçanërisht në komunën tuaj?

Në cilin drejtim duhet punuar më shumë për zhvillimin e rajonit të Prespës dhe komunës tuaj në veçanti?

Si do të ndihmonit ju konkretisht në mbrojtjen e pasurisë së Parkut të Prespës dhe zhvillimin e harmonizuar të komunës tuaj?

Në cilin drejtim duhet punuar për të zgjidhur problemet që lidhen me mbetjet shtëpiake dhe organike (mbetjet nga bagëtia), energjinë, etj?

Ju faleminderit që u bëtë pjesë e këtij procesi zhvillimi!